

Vendim nr. 209 datë 30.09.2024

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë, i përbërë nga:

Fiona Papajorgji,	Anëtare
Illir Toska,	Anëtar
Sandër Beci,	Anëtar

në datën 30.09.2024 mori në shqyrtim paraprak kërkesën nr. 24 (A) 2024 të Regjistrimit Themeltar, që i përket:

KËRKUESE: ALBANA RUCI, përfaqësuar nga avokat Thomas Dhimolea, me prokurë të posaçme.

OBJEKTI: Shfuqizimi i vendimit nr. 00-2024-1665, datë 25.04.2024 të Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë. Konstatimi i cenimit të së drejtës për gjykim brenda afatit të arsyeshëm dhe/ose përshpejtimi i procedurave të gjykimit.

BAZA LIGJORE: Nenet 42, 131 dhe 134 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë (*Kushtetuta*); neni 6 i Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut; ligji nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar (*ligji nr. 8577/2000*); neni 48, pika 2, i ligjit nr. 49, datë 03.05.2012 “Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, të ndryshuar (*ligji nr. 49/2012*).

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese (*Kolegji*), pasi dëgjoi relatorin e çështjes Sandër Beci, shqyrtoi kërkesën, dokumentet shoqëruese, si dhe diskutoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N:

I

Rrethanat e çështjes

1. Kërkuesja Albana Ruci ka qenë në marrëdhënie pune në Institucionin e Ekzekutimit të Vendimeve Penale Vlorë (*IEVP, Vlorë*). Në datën 02.08.2020 ajo është larguar për disa minuta nga vendi i punës si monitoruese e kamerave pranë këtij institucioni. Për këtë shkak drejtori i përgjithshëm i Burgjeve Tiranë ka marrë ndaj kërkueses masën disiplinore “*Largimi nga detyra*”, e cila është lënë në fuqi përsëri nga ai me urdhrin nr. 13117, datë 28.12.2020, edhe pas rishikimit të saj në bazë të vendimit të Komisionit të Apelimit të Masave Disiplinore (*KAMD*) pranë Ministrisë së Drejtësisë, ndërkohë që ky i fundit në vijim ka lënë në fuqi urdhrin e drejtorit të përgjithshëm të Burgjeve Tiranë.

2. Duke mos qenë dakord me këtë vendimmarrje, kërkuesja i është drejtuar Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Vlorë me kërkesëpadi me objekt: (a) anulimin e urdhrin të drejtorit të përgjithshëm të Burgjeve Tiranë dhe të vendimit të *KAMD*-së; (b) rikthimin në vendin e punës; (c) dëmshpërblimin me: (i) 12 paga mujore për zgjidhjen e menjëhershme e të pajustificuar të kontratës së punës nga punëdhënësi; (ii) 3 paga për mosrespektimin e afatit të njoftimit; (iii) 2 paga mujore për mosrespektimin e procedurës së zgjidhjes së kontratës së punës; (d) shpërblimin për vjetërsi në punë me pagën e 30 ditëve për çdo vit pune të plotë (për 12 vjet); (dh) interesat për këtë shumë të pagave (1 612 110 lekë) sipas normave të interesit të emetuara nga Banka e Shqipërisë nga data e ngritjes së padisë dhe deri në ekzekutimin e vendimit.

3. Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Vlorë, me vendimin nr. 264, datë 19.04.2022, ka pranuar pjesërisht padinë, duke vendosur shfuqizimin e urdhrin nr. 31117 prot., datë 28.12.2020 të nxjerrë nga drejtori i përgjithshëm i Burgjeve Tiranë, si një akt i nxjerrë në kundërshtim me ligjin; detyrimin e palës punëdhënëse të rikthejë në detyrë paditësen në pozicionin e punës, të cilën e ushtronte përpara se të largohej ose në ndonjë tjetër pozicion pune ekuivalent me të, në përputhje me arsimin dhe gradën e saj; si dhe detyrimin e palës së paditur të paguajë pagat të cilat do t'i përfitojë paditësja nga data 28.12.2020 dhe deri kur do të ekzekutohet vendimi gjyqësor. Me këtë vendim, gjykata ka vendosur edhe dhënien e tij me ekzekutim të përkohshëm në lidhje me pjesën e dispozitivit për rikthimin në detyrë dhe pagimin e pagës prej ditës së njoftimit të këtij vendimi të arsyetuar. Kundër këtij vendimi është paraqitur ankimi nga pala e paditur Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve dhe çështja është regjistruar në Gjykatën Administrative të Apelit në datën 19.10.2022.

4. Ndërkohë, ndonëse vendimi është dhënë me ekzekutim të përkohshëm, për shkak të paqartësisë në dispozitivin e vendimit, paditësja nuk i ka marrë të gjitha pagat që i detyrohej

IEVP-ja, Vlorë, por vetëm një pjesë të tyre dhe për këtë arsye ka kërkuar sqarimin e vendimit gjyqësor, kërkim i cili është pranuar nga Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Vlorë me vendimin nr. 26, datë 24.05.2023. Edhe ndaj këtij vendimi pala e paditur, Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve, ka paraqitur ankim të veçantë në Gjykatën Administrative të Apelit.

5. Në datën 24.11.2023 kërkesja i është drejtuar Gjykatës Administrative të Apelit me kërkesë për përshpejtimin e shqyrtimit të çështjes së themelit. Duke mos marrë përgjigje në lidhje me këtë kërkesë, bazuar në nenet 399/1 e vijues të Kodit të Procedurës Civile (*KPC*), në datën 17.01.2024 kërkesja i është drejtuar Gjykatës së Lartë me kërkesë për konstatimin e shkeljes së afatit të arsyeshëm dhe përshpejtimin e gjykimit të çështjes së themelit në Gjykatën Administrative të Apelit.

6. Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë, me vendimin nr. 00-2024-1665, datë 25.04.2024, ka vendosur rrëzimin e kërkesës me arsyetimin se mosveprimi i Gjykatës Administrative të Apelit nuk ka ndodhur për shkaqe subjektive, por ajo gjykatë ka qenë në pamundësi objektive për të gjykuar çështjen brenda afatit për shkak të ngarkesës totale të gjyqtarit, akumulimit ndër vite të dosjeve në gjykatë, e cila në kohën e regjistrimit të çështjes ka pasur në organikë pothuajse gjysmën e gjyqtarëve të planifikuar dhe shkurtimit të numrit të gjyqtarëve si rrjedhojë e reformës në drejtësi.

7. Në datën 21.06.2024 kërkesja ka paraqitur ankim kushtetues individual në Gjykatën Kushtetuese (*Gjykata*) për konstatimin e cenimit të së drejtës kushtetuese për një proces të rregullt ligjor nga Gjykata e Lartë.

II

Pretendimet e kërkuases

8. **Kërkesja**, në mënyrë të përmbledhur, ka pretenduar se i është cenuar:

8.1. *E drejta për një proces të rregullt ligjor* në drejtim të:

8.1.1. *Së drejtës për gjykim brenda një afati të arsyeshëm* si rrjedhojë e mosgjykimit të çështjes së saj nga Gjykata Administrative e Apelit brenda afatit të parashikuar nga neni 399/2, pika 1, shkronja “a”, i KPC-së. Ankimi në këtë gjykatë është depozituar në datën 19.10.2022, pra kanë kaluar 1 vit e 8 muaj nga depozitimi i saj në gjykatë dhe 3 vjet e 10 muaj nga largimi nga detyra dhe kjo çështje nuk është shqyrtuar ende.

8.1.2. *Standardit të arsyetimit të vendimit gjyqësor*, pasi Gjykata e Lartë në vendimin e saj, ndërsa citon kriterin e asaj çfarë përbën rrezik për kërkuosen,

si një nga pretendimet e saj, nuk ka arsyetuar fare rreth këtij fakti. Ajo ka dalë përtej qëndrimit të Gjykatës në vendimin e saj nr. 2/2022. Legjislatori me ligjin nr. 38/2017 ka parashikuar si zgjidhje efektive të drejtën për të kërkuar konstatimin e cenimit të afatit, përshpejtimin e procedurave dhe shpërblimin e dëmit si një mjet nxitës për marrjen e masave nga shteti. Njohja e shkeljes mund të qëndrojë edhe më vete si shpërblim edhe pa përshpejtimin e procedurave, përndryshe ky qëndrim i kolegjit, i cili, duke mos konstatuar shkeljen e afatit për efekt të kompensimit, do ta kthente në një mjet joefikas.

III

Vlerësimi i Kolegjit

A. Për legjitimitimin e kërkueses

9. Çështja e legjitimitimit (*locus standi*) është një ndër aspektet kryesore që lidhet me nisjen e një procesi kushtetues. Referuar neneve 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pikat 1, shkronja “i” dhe 2, të Kushtetutës, si dhe nenit 71 të ligjit nr. 8577/2000, çdo individ, person fizik ose juridik, subjekt i së drejtës private dhe publike, mund të vërë në lëvizje Gjykatën për gjykimin përfundimtar të ankesave kundër çdo akti të pushtetit publik ose vendimi gjyqësor që cenon të drejtat dhe liritë themelore të garantuara në Kushtetutë. Ankimi kushtetues individual, në çdo rast, duhet të plotësojë kriteret e nenit 71/a të ligjit nr. 8577/2000, që lidhen me shterimin e mjeteve juridike, afatin e paraqitjes së kërkesës, pasojat negative të pësura në mënyrë të drejtpërdrejtë e reale, mundësinë për rivendosjen e së drejtës së shkelur, si dhe rregullimet e veçanta ligjore të shqyrtimit paraprak të kërkesës.

10. Kërkuësja, si individ legjitimohet *ratione personae*, bazuar në nenet 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pika 1, shkronja “i”, të Kushtetutës, pasi është palë ndërgjyqëse në procesin gjyqësor ndaj të cilit ka ngritur pretendime në drejtim të standardit të gjyimit brenda një afati të arsyeshëm.

11. Një kriter tjetër është *shterimi i mjeteve juridike efektive*, i parashikuar nga neni 131, pika 1, shkronja “f”, i Kushtetutës dhe neni 71/a, pika 1, shkronja “a”, i ligjit nr. 8577/2000, që kërkon shfrytëzimin në rrugë normale të mjeteve juridike efektive, të cilat janë të përshtatshme, të disponueshme dhe të frytshme për një çështje konkrete. Lidhur me kërkesat për konstatimin e cenimit të së drejtës për gjykim brenda afatit të arsyeshëm, Gjykata, pas ndryshimeve që iu

bënë KPC-së me ligjin nr. 38/2017, ka mbajtur qëndrimin se legjislacioni i brendshëm parashikon mjete juridike efektive që i ofrojnë individit rezultate konkrete për rivendosjen e kësaj të drejte kushtetuese. Në këtë kuptim, individi duhet t'u drejtohet gjykatave të zakonshme, në përputhje me parashikimet e KPC-së, dhe vetëm pasi të ketë shteruar garancitë e mbrojtjes që i ofrohen nga juridiksioni i zakonshëm gjyqësor, ai mund të vërë në lëvizje gjykimin kushtetues (*shih vendimet nr. 68, datë 07.12.2023; nr. 46, datë 03.10.2023; nr. 44, datë 26.09.2023 të Gjykatës Kushtetuese*).

12. Në rastin konkret, vërehet se kërkuesja i është drejtuar asaj me ankim kushtetues individual, pasi ka paraqitur fillimisht kërkesë për përshpejtimin e gjykimit drejtuar Gjykatës Administrative të Apelit dhe më pas, në zbatim të neneve 399/5 - 399/6 të KPC-së, ka paraqitur kërkesë në Gjykatën e Lartë për konstatimin e shkeljes së afatit të arsyeshëm dhe përshpejtimin e shqyrtimit të çështjes, kërkesë e cila është rrëzuar nga Kolegji Administrativ me vendimin nr. 00-2024-1665, datë 25.04.2024. Për rrjedhojë, i vetmi mjet në dispozicion i kërkueses për rivendosjen e së drejtës së pretenduar të cenuar është ankimi kushtetues individual.

13. Kolegji vlerëson se kërkuesja legjitimohet edhe *ratione temporis*, në kuptim të përmbajtjes së nenit 71/a, pika 1, shkronja "b", të ligjit nr. 8577/2000, pasi jo vetëm që shkelja është vazhduese, por vendimi i Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë, për kërkesën për konstatimin e shkeljes së afatit të arsyeshëm, është i datës 25.04.2024, ndërsa kërkesa është paraqitur në Gjykatë në datën 21.06.2024, pra brenda afatit ligjor 4-mujor.

14. Për sa i takon legjitimitet *ratione materiae* vërehet se pretendimet e kërkueses për cenimin e së drejtës për proces të rregullt ligjor për shkak të mosgjykimin të çështjes së tij nga gjykata e apelit brenda afatit të arsyeshëm, si dhe ato në lidhje me standardin e arsytimit të vendimit, janë në funksion të pretendimit kryesor për tejzgjatjen e gjykimit të çështjes së saj, e cila, në kuptim të neneve 42 dhe 131, pika 1, shkronja "f", të Kushtetutës, bën pjesë në juridiksionin kushtetues.

B. Për shqyrtimin e çështjes brenda një afati të arsyeshëm

15. Kërkuesja ka pretenduar se nga Gjykata Administrative e Apelit nuk është respektuar afati i parashikuar nga neni 399/2, pika 1, shkronja "a", i KPC-së. Ankimi në këtë gjykatë është regjistruar në datën 19.10.2022, pra kanë kaluar 1 vit e 8 muaj nga regjistrimi i tij dhe 3 vjet e 10 muaj nga largimi nga detyra, për të ende nuk ka një vendimmarrje.

16. Neni 42 i Kushtetutës parashikon, ndër të tjera, se kushdo për mbrojtjen e të drejtave, lirive dhe interesave të tij kushtetues dhe ligjorë ose në rastin e akuzave të ngritura kundër tij, ka të drejtën e një gjykimi të drejtë dhe publik brenda një afati të arsyeshëm. Në jurisprudencën e saj Gjykata ka vlerësuar se kohëzgjatja e gjykimit, normalisht, llogaritet nga momenti i fillimit të procesit gjyqësor deri në dhënien e vendimit dhe se në kohëzgjatjen e përgjithshme të gjykimit nuk përjashtohen vonesat e shkaktuara nga zbatimi i reformës në drejtësi, pasi barra e këtyre vonesave nuk duhet të zhvendoset te palët ndërgjyqëse (*shih vendimet nr. 46, datë 03.10.2023; nr. 6, datë 16.02.2023; nr. 13, datë 26.05.2022 të Gjykatës Kushtetuese*).

17. Në rastin konkret, Kolegji vëren se mosmarrëveshja që po gjykohet nga gjykatat e juridiksionit të zakonshëm ka për objekt ligjshmërinë e ndërprerjes së marrëdhënieve të punës dhe zgjidhjen e pasojave në lidhje me të. Procesi gjyqësor është regjistruar në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Vlorë në datën 31.03.2021. Pas dhënies së vendimit të datës 19.04.2022 nga kjo gjykatë në favor të kërkueses, pala e paditur, Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve Tiranë, ka paraqitur ankim. Çështja është regjistruar në Gjykatën Administrative të Apelit në datën 19.10.2022 dhe ndonëse ka kaluar 1 vit e 8 muaj nga regjistrimi i çështjes, ende nuk ka një vendimmarrje për të.

18. Referuar nenit 399/2, pika 1, shkronja “a”, të KPC-së, përbën afat të arsyeshëm përfundimi i gjykimit administrativ në gjykatën e apelit brenda një viti. Kjo nënkupton se formalisht gjykimi i çështjes në Gjykatën Administrative të Apelit ka tejkaluar afatin e përcaktuar ligjor, ndaj për të vlerësuar arsyet e kësaj kohëzgjatjeje dhe për të arritur në përfundimin nëse kërkueses i është cenuar e drejta kushtetuese për proces të rregullt në këtë aspekt, do të analizohen këto kritere: (i) sjellja e kërkuetit; (ii) kompleksiteti i çështjes; (iii) sjellja e autoriteteve; (iv) rëndësia e asaj çfarë rrezikon kërkueti (*shih vendimet nr. 46, datë 03.10.2023; nr. 6, datë 16.02.2023; nr. 13, datë 26.05.2022 të Gjykatës Kushtetuese*).

19. Në lidhje me *sjelljen e kërkuetit*, Kolegji vëren se kërkuetja, pasi ka konstatuar se nuk është planifikuar një datë për shqyrtimin e ankimit të Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve, Tiranë të regjistruar në Gjykatën Administrative të Apelit, në datën 24.11.2023 i është drejtuar asaj gjykate për përshpejtimin e gjykimit dhe më pas në mungesë të përgjigjes nga kjo gjykatë, në datën 17.01.2024, i është drejtuar Gjykatës së Lartë me kërkesën për konstatimin e shkeljes së afatit të arsyeshëm dhe përshpejtimin e procedurave. Kjo kërkesë është rrëzuar nga Gjykata e Lartë në datën 25.04.2024 dhe sërish çështja ka mbetur pa veprime, në pritje të planifikimit për një datë shqyrtimi. Kërkuetja, pasi është njohur me

vendimin e Gjykatës së Lartë, ka paraqitur ankim kushtetues individual, sipas objektit. Për rrjedhojë, kërkesja ka vepruar në përputhje me të drejtat e saj procedurale dhe nuk rezulton të jetë bërë shkak ose të ketë shkaktuar vonesa në gjykimin e çështjes.

20. Për sa i takon *kompleksitetit të çështjes*, Kolegji vëren se çështja e kërkueses është me natyrë administrative, pasi ka si objekt ndërprerjen e marrëdhënieve të punës nga punëdhënësi, Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve. Ajo nuk paraqet rrethana të vështira ose komplekse të tilla që të justifikojnë vonesën në shqyrtimin e saj. Nga shqyrtimi i dokumentacionit të paraqitur konstatohet se kërkesëpadia ka në objekt të saj dy kërtime që lidhen ndërmjet tyre, atë të dëmshpërblimit për zgjidhjen e menjëhershme e të pajustificuar të kontratës së punës nga punëdhënësi, anulimin e urdhrit të drejtorit të përgjithshëm të Burgjeve dhe rikthimin në vendin e punës. Për rrjedhojë, duke iu referuar aspekteve të mësipërme, vlerësohet se çështja e kërkueses nuk paraqet kompleksitet, të tillë që të justifikojë kohëzgjatjen e shqyrtimit të saj prej 1 viti e 8 muajsh në Gjykatën Administrative të Apelit.

21. Për sa i përket *sjelljes së autoriteteve*, duke mbajtur në konsideratë për sa është theksuar nga Gjykata e Lartë për situatën aktuale të ngarkesës në sistemin gjyqësor, Kolegji vëren se çështja e kërkueses është në pritje për t'u gjykuar tashmë prej 1 viti e 8 muajsh në gjykatën e apelit ndonëse ligjvënësi ka parashikuar afate procedurale konkrete në KPC. Gjykata e Lartë e ka rrëzuar kërkesën duke vlerësuar se mosveprimi i Gjykatës Administrative të Apelit nuk ka ndodhur për shkaqe subjektive që lidhen me vlerësime dhe qëndrime abuzive të gjyqtarit relator, por se ajo ka qenë në pamundësi objektive për të gjykuar çështjen brenda një afati të arsyeshëm, për shkak të ngarkesës totale të gjyqtarit, akumulimit ndër vite të dosjeve në gjykatë e cila në kohën e regjistrimit të çështjes ka pasur në organikë pothuajse gjysmën e gjyqtarëve të planifikuar dhe shkurtimit të numrit të gjyqtarëve si rrjedhojë e reformës në drejtësi. Sikurse arsyeton Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë, relatori i çështjes, nëpërmjet shkresës nr. 180/1, datë 04.04.2024, ka parashtruar se çështja i ka kaluar me short në datën 11.01.2024. Referuar datës së shortit dhe kërkesës për konstatimin e shkeljes së afatit kanë kaluar vetëm 6 ditë. Ai ka 2280 dosje që presin për t'u gjykuar prej tij dhe se po planifikon mesatarisht të shqyrtojë 30 çështje në muaj. Aktualisht prej tij po gjykohen çështje të muajve maj-qershor 2017.

22. Së fundmi, në lidhje me *rëndësinë e asaj çfarë rrezikon kërkuesi*, Gjykata ka vlerësuar se disa kategori çështjesh, për shkak të natyrës së tyre, kërkojnë përshpejtim të posaçëm të gjykimit, nisur nga interesi veçanërisht i lartë i kërkuetit. Disa çështje që lidhen

me interesa “vetjakë e jetësorë ” nevojitet të trajtohen me shpejtësi e përparësi. Të tilla janë çështjet që kërkojnë “kujdes të veçantë” ose “kujdes të jashtëzakonshëm”, si ato që lidhen me statusin civil, kujdestarinë e fëmijëve, marrëdhëniet e punësimit, sëmundjet e pashërueshme, pensionin. Lista e këtyre çështjeve nuk mund të jetë shteruese dhe kriteri i interesit të kërkuarit në proces verifikohet nga Gjykata rast pas rasti (*shih vendimet nr. 43, datë 04.06.2024; nr. 21, datë 04.04.2024, nr. 6, datë 16.02.2023 të Gjykatës Kushtetuese*).

23. Në rastin në shqyrtim, Kolegji vëren se, në thelb, çështja e kërkuarës ka të bëjë me dëmshpërblimin për zgjidhjen e kontratës së punës dhe rikthimin në vendin e punës, për të cilën gjykata e shkallës së parë ka vendosur rikthimin në detyrë të kërkuarës dhe detyrimin e Drejtorisë e Përgjithshme e Burgjeve t’i paguajë asaj pagat për kohën e qëndrimit padrejtësisht pa punë. Për këto disponime vendimi është dhënë me ekzekutim të përkohshëm, ndërsa pranohet se pala e paditur ka kryer veprime për ekzekutimin e tij, duke përmbushur (pjesërisht) detyrimin për pagimin e pagës. Nga ana tjetër, nuk jepet informacion për ekzekutimin e atij vendimi për sa është urdhëruar nga gjykata, por gjithsesi ligji ka parashikuar për palët mjetet mbrojtëse nga ekzekutimi.

24. Gjithashtu, bazuar në argumentet e paraqitura në kërkesë, Kolegji vlerëson se kërkuarja nuk ka arritur të parashtrijë shkaqe të mjaftueshme për të provuar se çështja e saj është e një natyre të tillë që interesi i saj rrezikohet në shkallë të konsiderueshme nga kohëzgjatja e procedurave gjyqësore. Për rrjedhojë, Kolegji arrin në përfundimin se çështja e saj, për shkak të natyrës lidhet me interesa *vetjakë e jetësorë*, por se në kontekst të rrethanave të rastit, duke qenë se vendimi i gjykatës së shkallës së parë është dhënë me ekzekutim të përkohshëm, procesi në gjykatën e apelit nuk rezulton se është i tillë që duhet të shqyrtohet me prioritet nga ajo gjykatë. Në këto kushte, në lidhje me *rëndësinë e asaj çfarë rrezikon kërkuarja* për shkak të vonesës së gjykatës së apelit në shqyrtimin e çështjes së saj, Kolegji vlerëson se kërkuarja nuk ka argumentuar dhe provuar rrezikun për interesat e saj, natyra dhe rëndësia e të cilave të justifikojë trajtimin me përparësi dhe shpejtësi të veçantë të çështjes së saj.

25. Nisur nga sa më lart, duke vlerësuar së bashku përfundimet e analizës të secilit prej standardeve të lartpërmendura kushtetuese, Kolegji çmon se në rrethanat e rastit konkret, pavarësisht se formalisht afatet ligjore nuk janë respektuar, kohëzgjatja e shqyrtimit të çështjes së kërkuarës në Gjykatën Administrative të Apelit në raport me situatën aktuale të

ngarkesës në gjykatat e juridiksionit të zakonshëm, si dhe me rëndësinë e asaj çfarë rrezikon kërkuesja, nuk duket të ketë tejkaluar një kufi kohor i arsyeshëm në aspektin kushtetues.

26. Në përfundim, Kolegji vlerëson se kërkesa nuk përmbush kriteret paraprake, për rrjedhojë nuk mund të kalojë për shqyrtim në seancë plenare.

PËR KËTO ARSYE,

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese, në bazë të neneve 31 dhe 31/a, pika 2, shkronja “e”, e ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar,

V E N D O S I:

Moskalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare.